



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.08.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-1053/14, për z. Liridon Mavriqi – ish – Këshilltar Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit dhe as kufizimin pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1053/14, për z. Liridon Mavriqi – ish – Këshilltar Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje LPKI).

Në këtë rast, ish zyrtari i lartë z. Mavriqi, është hetuar për mundësinë e ekzistimit të konfliktit të interesit si ish këshilltar politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe më pas, përzgjedhjes si menaxher i Projektit për Njësinë e Implementimit të Projektit (NjIP) “TC Kosova e Re”.

Pas pranimit të informatës për mundësinë e ekzistimit të konfliktit të interesit, Agjencia kundër Korrupsionit ka iniciuar këtë rast duke mbledhur faktet dhe provat relevante të cilat kryesisht janë vënë në dispozicion nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në të cilën z. Mavriqi ishte i punësuar.

Pas shqyrtimit të rastit, në pajtim me dispozitat dhe mandatin e përcaktuar ligjor, duke i marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se në këtë situatë nuk ka konflikt interesi dhe as kufizim pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, ashtu siç parashihet me nenin 17 të LPKI.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

